



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry



AGJENCIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

RAPORTI I INDIKATORËVE BAZË TË PERFORMANCËS PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË PËR PERIUDHËN: KORRIK – SHTATOR 2018

AGJENCIA PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE TË KOSOVËS

TETOR 2018

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	3
II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE	4
III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE	4
IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT	5
V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE	8
VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA SIPAS VENDIT TË ORIGJINËS ..	8
VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ	9
VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË	9
IX. PËRFUNDIM.....	11

I. HYRJJE

Ky raport është rezultat i vlerësimit të kryer për tremujorin e tretë të vitit 2018 nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejme “ARBK”) të disa indikatorëve të performancës lidhur me procesin e regjistrimit të shoqërive tregtare në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe, një ekip i përbërë nga zyrtarët e ARBK-së kanë analizuar një sërë indikatorësh të lidhur me performancën e ARBK-së:

- Kohën për regjistrim të shoqërive tregtare në përgjithësi në Kosovë dhe për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar në veçanti, si dhe sipas komunave;
- Numrin total të shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe sipas numrit total të shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës së shoqërive tregtare;
- Numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara sipas vendit të origjinës;
- Numrin e pronarëve, ortakëve ose aksionarëve të huaj të përfshirë në shoqëritë tregtare të Kosovës sipas llojit të shoqërive tregtare;
- Përqindjen e bizneseve individuale në pronësi të grave; dhe
- Përqindjen e ortakëve ose aksionarëve sipas gjinisë në shoqëritë tregtare në Kosovë.

Me avancimin e mëtutjeshëm të procesit të regjistrimit të shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe përpjekjet për funksionalizimin e regjistrimit të plotë elektronik, pritet që numri i indikatorëve dhe cilësia e të dhënave të rriten dhe të pasqyrohen në raportet pasuese.

Ky raport analizon të dhënat e nxjerra nga regjistri i shoqërive tregtare të ARBK-së për shoqëritë tregtare që me ligje të veçanta në Kosovë kërkohen të regjistrohen në ARBK. Ky raport nuk bën ndonjë supozim dhe nuk ofron shifra lidhur me shoqëritë tregtare që janë aktive dhe funksionojnë në Kosovë, mirëpo fokusohet kryesisht në matjen e efikasitetit të ARBK-së dhe qendrave komunale të regjistrimit në zhvillimin e procedurave të regjistrimit ose çregjistrimit të shoqërive tregtare.

Nga krahasimi i të dhënave për këtë tremujor që përfshin periudhën I Korrik - 30 Shtator 2018 me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar Korrik – Shtator 2017 vërehet një ngritje e kohës së regjistrimit për të gjitha shoqëritë tregtare prej **16.67%**.

Për qëllime të këtij raporti, ditët janë llogaritur në bazë të matjes së ditëve të punës. Krahasimi mes mesatareve kumulative të ditëve të tremujorit të kaluar (“vlera e vjetër”) me mesataret kumulative të ditëve të tremujorit aktual (“vlera e re”) është llogaritur duke përdorur formulën e ndryshimit në përqindje¹.

Për të marrë një pasqyrë më të qartë të numrit, madhësisë, dhe statusit funksional të shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera ekonomike të angazhuara në veprimtari ekonomike në Kosovë, ekziston nevoja për një përpjekje më gjithëpërfshirëse duke përfshirë institucionet tjera qeveritare, në radhë të parë Administratën Tatimore të Kosovës dhe Ministrinë e Administratës Publike.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera të zbatueshme, ARBK aktualisht regjistron këto forma të shoqërive tregtare: Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, Shoqëri Aksionare, Degë e Shoqërisë së Huaj Tregtare dhe Kooperativë Bujqësore.

¹ Vlera e re (V2) - Vlera e vjetër (V1) ÷ Vlera e vjetër (V1) × 100% = Ndryshimi në përqindje

II. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE

Shoqëritë tregtare, siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, kërkohen të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare nëpër Kosovë. Kjo pjesë e raportit matë numrin e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

Grafiku I paraqet mesataren totale të ditëve, bazuar në regjistrimin e të gjitha formave ligjore të shoqërive tregtare, përkundër ndryshimeve të mëdha në kohën për regjistrimin e llojeve të ndryshme, p.sh. koha për regjistrimin e një biznesi individual është dukshëm më e shkurtër se koha për regjistrimin e një shoqërie aksionare.

Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e të gjitha shoqërive tregtare për tremujorin e njëjtë të vitit 2017 ka qenë 1.80 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve është rritur në 2.10 ditë, paraqet rënje prej 16.67%.


Grafiku I: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të shoqërive tregtare, Korrik – Shtator 2018:



III. MESATARJA E DITËVE PËR REGJISTRIMIN E SHPK-VE


Kjo pjesë e raportit analizon kohën për regjistrim të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK). Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve për tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 2.10 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve është ngritur në 2.57 ditë, që paraqet rënje prej 22.38%.

Grafiku 2: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve, Korrik - Shtator 2018:



Për më tepër, Grafiku 3 tregon mesataren e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve në qendrën e regjistrimit të ARBK-së në Prishtinë. Mesatarja kumulative e ditëve për regjistrimin e SHPK-ve në Prishtinë për tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 2.08 ditë, që në krahasim me këtë tremujor kur mesatarja kumulative e ditëve është rritur në 3.04 ditë, paraqet një rënie prej 46.02%. Kjo rënie e performancës është si rezultat i numrit më të madh të aplikacioneve për shkak të disa skemave për grante dhe subvencione për sektorin privat të implementuara nga Qeveria.

Grafiku 3: Numri mesatar i ditëve për regjistrim të SHPK-ve në qendrën e regjistrimit në Prishtinë, Korrik – Shtator 2018:



IV. KOHA PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS QENDRËS SË REGJISTRIMIT

Tabela I tregon numrin mesatar të ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas qendrave komunale të regjistrimit të shoqërive tregtare. Tabela e shfaqur përfshin 29 qendrat komunale për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë.

Ndarja sipas qendrave të regjistrimit në tabelën më poshtë është krijuar në bazë të dhënave të adresës së regjistruar të shoqërive tregtare. Nëse një shoqëri tregtare e ka adresën e regjistrimit në Gjilan, është përdorur supozimi se shoqëria tregtare është regjistruar në qendrën e regjistrimit në Gjilan, edhe pse ekziston mundësia që ajo shoqëri tregtare të jetë regjistruar në qendrën kryesore të ARBK-së në Prishtinë. Kjo është për arsye se ARBK aktualisht ka një sistem unik të regjistrimit të shoqërive tregtare i cili përfshin të dhënat për shoqëritë tregtare të regjistruara në të gjithë territorin e Kosovës, pra jo sipas qendrës së regjistrimit.

Tabela I: Numri mesatar i ditëve për regjistrimin e shoqërive tregtare sipas Qendrave për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare, Korrik – Shtator 2018:

Qendra e Regjistrimit	Korrik	Gusht	Shtator	Mesatarja (ditë)	Nr. Bizneseve të regjistruara
Hani i Elezit	2.00	1.25	2.50	1.75	8
Shtërpce	5.67	7.50	2.33	4.88	8
NovoBërdë	1.00		1.88	1.70	10
Dragash	1.00	1.80	1.00	1.21	19
Obiliq	1.67	1.33	1.75	1.61	23
Graçanicë	1.89	1.67	2.17	1.88	24
Kaçanik	1.91	1.00	1.57	1.58	24
Deçan	1.50	1.50	2.00	1.62	26
Shtime	3.00	1.64	2.67	2.31	26
Skenderaj	2.00	1.14	1.83	1.67	27
Glllogoc	1.27	2.00	1.33	1.45	29
Kamenicë	1.70	1.14	1.33	1.41	29
Klinë	2.13	3.25	2.07	2.39	31
Suharekë	2.41	1.33	1.00	1.73	37
Lipjan	1.27	2.00	2.00	1.71	38
Mitrovica Veriore	2.00	2.50	1.53	2.00	38
Istog	1.36	1.00	1.80	1.48	44
Malishevë	1.72	1.29	1.86	1.72	46
Rahovec	2.45	1.20	2.14	2.09	46
Viti	1.84	1.36	2.00	1.81	53
Vushtrri	1.90	2.29	1.88	2.02	53
Podujevë	1.38	1.30	1.32	1.33	78
Fushë Kosovë	2.12	3.19	2.72	2.68	84
Gjakovë	1.43	1.81	1.63	1.61	84
Mitrovicë	1.78	1.88	1.75	1.78	93
Pejë	1.82	1.51	1.94	1.75	115
Gjilan	1.61	1.65	1.78	1.67	135
Prizren	1.32	1.18	1.50	1.33	164
Ferizaj	2.26	1.71	2.05	2.02	193
Prishtinë	2.27	2.91	3.14	2.77	667
Mesatarja	1.93	2.19	2.18	2.10	2,252

*Ngjyra e kuqe paraqet mesatare të madhe të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

*Ngjyra e gjelbër paraqet mesatare të vogël të ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare.

V. REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI SIPAS FORMËS LIGJORE TË SHOQËRIVE TREGTARE

Tabela 2 më poshtë paraqet numrin e shoqërive tregtare të regjistruara dhe numrin e shoqërive tregtare të çregjistruara sipas formës ligjore të shoqërive tregtare dhe muajit të regjistrimit për periudhën Korrik – Shtator 2018. Forma ligjore me numrin më të madh të regjistrimeve gjatë këtij tremujori ka qenë Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar, e pasuar nga Biznesi Individual. Forma ligjore me numrin më të madh të çregjistrimeve është Biznesi Individual, pasuar nga Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Tabela 2: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara dhe çregjistruara sipas formës ligjore, Korrik – Shtator 2018:

Regjistrimi sipas formës ligjore	Muaji	Biznese Individuale	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Dega e Kompanisë së Huaj	Kooperativa Bujqësore	Ndërmarrje shoqërore	Totali
Shoqëri Tregtare të Regjistruara	Korrik	329	1		439	2	8	1		780
	Gusht	305			369	1	7		1	683
	Shtator	405	1		379		2	1	1	789
	Totali	1,039	2		1,187	3	17	2	2	2,252
Shoqëri Tregtare të Çregjistruara	Korrik	122	6		11	1	2			142
	Gusht	93	2		9		1			105
	Shtator	74	1		16	1				92
	Totali	289	9		36	2	3			339

VI. REGJISTRIMI I DEGËVE TË SHOQËRIVE TË HUAJA TREGTARE SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në ARBK dhe Qendrat Komunale të Regjistrimit bëhet regjistrimi edhe i degëve të shoqërive të huaja tregtare. Tabela 3 më poshtë tregon numrin total të degëve të shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për periudhën Korrik – Shtator 2018.

Tabela 3: Degët e shoqërive të huaja tregtare të regjistruara në Kosovë sipas vendit të originës, Korrik – Shtator 2018:

Vendi i originës së shoqërive të huaja tregtare	Degët e shoqërive të huaja tregtare
Kroaci	1
Gjermani	3

Serbi	1
Mali I zi	1
Shqipëri	7
Turqi	3
Zvicër	1
TOTALI	17

VII. NUMRI I SHOQËRIVE TREGTARE NË TË CILAT ËSHTË I PËRFSHIRË SË PAKU NJË PRONAR, ORTAK OSE AKSIONAR I HUAJ

Të dhënat në Tabelën 4 paraqesin numrin e shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj. Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2018 janë regjistruar gjithsej 2,252 shoqëri tregtare nga të cilat 164 kanë një person të huaj fizik ose juridik si pronar, ortak ose aksionar. Nga ky numër janë përjashtuar degët e shoqërive të huaja tregtare që janë paraqitur në Tabelën 3.

Siç mund të shihet në Tabelën 4, forma ligjore më e regjistruar e shoqërive tregtare në mesin e personave të huaj është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar.

Tabela 4: Numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një pronar, ortak ose aksionar i huaj, Korrik – Shtator 2018:

Muaji	Biznes Individual	Ortakëria e Përgjithshme	Ortakëria e Kufizuar	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	Shoqëri Aksionare	Totali
Korrik	11			59		70
Gusht	3			43	2	48
Shtator	5			41		46
Totali	19			143	2	164

*Këto të dhëna nuk paragjykojnë përqindjen e kapitalit të personave të huaj. Qëllimi i kësaj tabele është paraqitja e pjesëmarrjes së personave të huaj si pronarë, ortakë ose aksionarë në shoqëri tregtare në Kosovë.


*Nga kjo tabelë është përjashtuar numri i "Degëve të Shoqërive të Huaja Tregtare" që është paraqitur në Tabelën 3.

VIII. REGJISTRIMI I SHOQËRIVE TREGTARE SIPAS GJINISË

Të dhënat në Grafikon 4 dhe 5 paraqesin pjesëmarrjen gjinore në shoqëritë tregtare të regjistruara gjatë periudhës Korrik – Shtator 2018. Për shkak të natyrës të formave të ndryshme ligjore të shoqërive tregtare, të dhënat më poshtë paraqiten ndaras për Bizneset Individuale, të cilat kanë pronar të vetëm dhe janë zakonisht biznese të vogla, dhe ndaras për format ligjore të tjera të shoqërive tregtare ku pronarët marrin pjesë si ortakë apo aksionarë në shoqëri tregtare më të mëdha ose më diverse.


Grafiku 4 tregon përqindjen e pronarëve femra dhe meshkuj në Biznese Individuale.

Grafiku 4: Përqindja e Bizneseve Individuale sipas Gjinisë, Korrik – Shtator 2018:



Grafiku 5 tregon përqindjen e ortakëve ose aksionarëve të shoqërive tregtare sipas gjinisë të regjistruar, me përjashtim të bizneseve individuale dhe degëve të shoqërive të huaja tregtare.

Grafiku 5: Përqindja e Ortakëve dhe Aksionarëve sipas Gjinisë, Korrik – Shtator 2018:



IX. PËRFUNDIM

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në mënyrë që të përmirësoj akoma më shumë efikasitetin e regjistrimit në ARBK ka ndërmarrë një sërë veprimesh:

- Ka iniciuar zhvillimin, institucionalizimin dhe përdorimin e rregullt të matjeve të performancës duke nxjerrë nga të dhënat zyrtare të regjistrimit për të monitoruar kohën për përpunimin e aplikacioneve për regjistrim nëpër qendrat komunale të regjistrimit dhe për të identifikuar performuesit më të mirë si dhe ata më të përmirësuarit;
- Platforma e re elektronike është në proces të zhvillimit dhe në fund të këtij viti pritet të funksionalizohet;
- Ka rritur fokusin në sigurimin e pajtueshmërisë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare që aktualisht është në proces të ndryshim-plotësimit;

Publikimi i raporteve të rregullta të matjes së performancës të përgatitura dhe publikuara nga ARBK shërbejnë si mjet informues për përmirësimet e mëtutjeshme të procesit.


FAKTE TË SHPEJTA LIDHUR ME REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të shpejtë të të dhënave të paraqitura në raportin “Indikatorët Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë” për periudhën Korrik – Shtator 2018.

Ky raport dhe kjo përmbledhje janë përgatitur nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Këto të dhëna paraqesin shifra të ndryshme, duke filluar nga mesatarja e ditëve për regjistrimin e një shoqërie tregtare e deri tek numri i shoqërive tregtare në të cilat është i përfshirë së paku një person i huaj si pronar, ortak ose aksionar.

PËRMBLEDHJE PËR PERIUDHËN KORRIK – SHTATOR 2018



**PËRMBLEDHJE E BIZNESEVE AKTIVE PREJ
1999 – SHTATOR 2018**

